

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare

Shoqëria Koncesionare Noa Inspect shpk

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

# Përmbajtja

	Faqe
<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b>	<b>i-iii</b>
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE</b>	<b>4</b>
<b>SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>5-17</b>

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e Shoqëria koncesionare Noa Inspect shpk

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë koncesionare Noa Inspect shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.

### *Bazë për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

### *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiareose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm, të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri  
28 korrik 2020


*Kledian Kocha, FCA*  
*Koch*




## Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2019
<b>Aktivet</b>		
<b>Aktivet afatshkurtra</b>		
Mjete monetare	5	8,869,271
Aktive të tjera	6	16,215,868
<b>Totali i aktive afatshkurtra</b>		<b>25,085,139</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>		
Aktive jo-materiale në proces - e drejtë koncesionare	7	71,652,037
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>71,652,037</b>
<b>Aktivet totale</b>		<b>96,737,176</b>
<b>Detyrimet</b>		
<b>Detyrimet Afatshkurtra</b>		
Llogari të pagueshme	8	9,773,578
Detyrime të tjera	9	516,656
Detyrime ndaj palëve të lidhura	10	99,364,564
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>109,654,798</b>
<b>Kapitali</b>		
Kapitali i paguar	11	1,000,000
Fitimi i pashpërndarë		(13,917,622)
<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>(12,917,622)</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>96,737,176</b>

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqëria koncesionare Noa Inspect shpk më dhe firmosur për llogari të tyre nga:

  
Matiel Hoxha  
Administrator

  
Lindita Metalla  
Ekonomiste

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## Pasqyra e Performancës Financiare

	Shënime	31 dhjetor 2019
<b>Të ardhurat operative</b>		
Të ardhura nga shërbimet		-
<b>Shpenzimet operative</b>		
Shpenzime administrative	12	(9,814,922)
Shpenzime personeli	13	(3,535,976)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(13,350,898)</b>
<b>Humbja operative</b>		<b>(13,350,898)</b>
Të ardhura/shpenzime nga interesi		-
Fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit, neto		(566,724)
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(13,917,622)</b>
Shpenzim tatim fitimi	14	-
<b>Humbja neto për vitin</b>		<b>(13,917,622)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të tjera gjithëpërfshirëse</b>		<b>(13,917,622)</b>

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksionar	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 18 Korrik 2019	1,000,000	-	1,000,000
Humbja për vitin	-	(13,917,622)	(13,917,622)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,000,000</b>	<b>(13,917,622)</b>	<b>(12,917,622)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



## Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2019
<b>Flukset monetare nga aktiviteti operativ</b>		
Fitimi para tatimit		(13,917,622)
Rregullime për:		
<i>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:</i>		
Aktive të tjera		(16,215,868)
Detyrime ndaj palëve të lidhura dhe të tjera		109,654,798
<b>Mjetet monetare të përdorura nga aktivitetet operative</b>		<b>79,521,308</b>
Tatimi fitimi i paguar		-
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet operative</b>		<b>79,521,308</b>
<b>Flukset monetare nga aktiviteti investues</b>		
Shpenzime kapitale per koncesionin		(71,652,037)
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese</b>		<b>(71,652,037)</b>
<b>Flukset monetare nga aktiviteti financues</b>		
Kapital i paguar		1,000,000
<b>Flukset monetare nga aktiviteti financues</b>		<b>1,000,000</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre</b>		<b>8,869,271</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit</b>		<b>-</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>		<b>8,869,271</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5- 17 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Shënime për Pasqyrat Financiare

## 1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Koncesionare "Noa Inspect" Shpk u themelua në 18 Korrik 2019 si Person Juridik me NIPT L91918012B.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 'Për Shoqëritë Tregtare, dhe nga statuti i saj.

Me datë 28 gusht 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë si Autoriteti Kontraktues, NOA Control si koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare NOA Inspect si shoqëri koncesionare kanë lidhur një kontratë koncesionare.

Shoqëria Koncesionare ka si objekt të veprimtarisë së saj hartimin e Projektit përfundimtar, projektimin, vënien në punë të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarese të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe transferimin e pajisjeve të Sistemit Operativ tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të afatit të Koncesionit.

Mbi bazën e kontratës koncesionare, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 70,000,000 lekë. Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës ka siguruar në një shoqëri sigurimi për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 7,000,000 lekë që përbën 10% të vlerës totale të investimit për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

Ky koncesion jepet për një periudhë prej 20 vjetësh nga data efektive. Data efektive është 31 mars 2020.

Tarifat e shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit ose gazit të lëngshëm do të jenë sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave nr 2 datë 08.02.2013. Në asnjë rast nuk mund të jenë më të ulëta se sa në udhëzim.

Kategoritë kryesore të investimeve dhe kostove të fillimit të projektit janë:

1. Investimi për autolaboratorët, që përfshin investimin për pajisjet testuese, investimit për mjetet motorrike, ku do të vendosen pajisjet testuese, si dhe kosto të tjera për përgatitjen e mjeteve.
2. Investimi për software dhe për pajisjet kompjuterike
3. Investimi për pajisje të tjera dhe kosto të fillimit

Sistemet matëse të karburantit janë zëri më i madh i investimit dhe janë të përfshira në kategorinë e parë.

Shoqëria ka të punësuar 22 punonjës në dhjetor 2019.

Administratori i Shoqërisë është z. Matiel Hoxha.

## **2 Bazat e përgatitjes dhe deklarata e përputhshmërisë**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Detajat e politikave të rëndësishme kontabël të Shoqërisë janë përfshirë në Shënimin 3.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

### **2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

#### **2.4.1 Gjykime**

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, përfshihet më poshtë:

***Marrëveshjet për koncesionin:*** përdorimi i qasjes të modelit të vetëm që është modeli i aktivitetit jo material. (Shënim 7).

***Parimi i vijimësisë.*** Drejtimi i përgatiti këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në kryerjen e këtij gjykimi, drejtimi kreu një analizë të hollësishme duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat në dispozicion dhe pozicionin financiar të Shoqërisë, qëllimet aktuale, përmirësimin e pritshëm të përfitimit të operacioneve dhe aksesin në burimet financiare, në mënyrë që të konkludojë nëse Shoqëri mund të vazhdojë të funksionojë në përputhje me parimin e vijimësisë në të ardhmen e parashikueshme. Nën "të ardhmen e parashikueshme", drejtimi merr në konsideratë të gjitha informacionet e disponueshme për të ardhmen, e cila është të paktën, por nuk kufizohet në, dymbëdhjetë muaj nga përfundimi i periudhës së raportimit. Përfundimi nga analiza e mësipërme është se Shoqëria nuk përballë me ndonjë problem operimi dhe nuk parashikon ndonjë të tillë deri në fund të vitit 2020. Për më tepër, drejtimi i NoA Inspect ka shprehur angazhimin e tij për të vazhduar mbështetjen e operacioneve të Shoqërisë

### **3 Përmbledhje e politikave kontabël**

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të prezantuara më poshtë.

#### **3.1 Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të momentit kur përcaktohet vlera e drejtë.

Zërat jo-monetarë që maten bazuar në koston historike në monedhë të huaj, përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga konvertimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje.

Monedha Euro (e cila është monedha kryesore me të cilën operon shoqëria) u konvertua me kursin 121.77 (2018: 123.42) lekë.

#### **3.2 Instrumentet financiarë**

Instrumentet financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë:

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar, ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur në thelb kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivitet.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### **3.2.1 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtër me bankat, të cilat fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozitat pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre.

### **3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.2 Instrumentet financiarë (vazhdim)**

##### **3.2.2 Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera**

Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme regjistrohet kur ekzistojnë prova objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në afatet fillestare të përcaktuara. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të riorganizohet financiarisht konsiderohen tregues që llogaria e arkëtueshme është zhvlerësuar. Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara, të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit.

##### **3.2.3 Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera**

Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### **3.2.4 Huamarrjet**

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë minus koston e transaksionit ndërsa më pas me koston të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### **3.2.5 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse**

Titujt e pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse njihen fillimisht me koston, dhe më pas maten me koston minus humbjet nga zhvlerësimi.

##### **3.2.6 Të tjera**

Instrumente të tjerë financiarë joderivativë maten me koston të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### **3.2.7 Vlera e drejtë**

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, minus çdo zhvlerësim, supozohen të jenë të përafërta me vlerat e tyre kontabël.

#### **3.3 Aktivet afatgjata jomateriale**

Bazuar në SKK 13, Shoqëria njih një aktiv jomaterial që rrjedh nga një marrëveshje koncesionare, kur ajo ka të drejtë të tarifojë përdoruesit e shërbimit publik. Një aktiv jomaterial i marrë si konsideratë për ofrimin e shërbimeve të ndërtimit ose të përmirësimit në një marrëveshje koncesionare të shërbimit, matet me vlerën e drejtë në momentin e njohjes fillestare, duke ju referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ofruara. Më tej për kontabilizimin e aktivitetit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

### 3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### 3.3 Aktivët afatgjatë jomateriale (vazhdim)

Jeta ekonomike e një aktivi jo-material në një kontratë koncensionale është periudha kur ai është i vlefshëm për t'u përdorur deri në përfundim të periudhës së koncensionit. Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) në mënyrë lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të çdo pjese të aktivit. Metodatat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen në çdo datë raportimi.

Aktivi jo-material përfshin koston e blerjes së licensës, pajisjeve, mjeteve dhe software.

Licensa për ofrimin e shërbimit do të amortizohet për të gjithë periudhën e koncensionit.

Jetëgjatësia e elementëve të tjerë të investimit është si më poshtë:

Kategoritë e investimit	Jeta e dobishme
Sistemet matëse dhe pajisje mbështetëse	10 vjet
Mjete motorike	5 vjet
Investimi për software	5 vjet
Pajisje kompjuterike	5 vjet
Investimi për pajisje të tjera (mobilje, certifikime)	5 vjet

#### 3.4 Zhvlerësimi

##### (i) Aktivët financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivët financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### (ii) Aktivët jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese mjeteshe monetare (CGU) është më e madhja midis vlerës së saj në përdorim dhe vlerës së drejtë të saj minus kostot e shitjes. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara monetare skontohen duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Për qëllime të testimit të zhvlerësimit, aktivët grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë hyrje të mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga hyrjet në mjete monetare të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve ("CGU").

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e "CGU" së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga zhvlerësimi në lidhje me "CGU" janë shpërndarë për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve në njësi (grup njësishe) në baza proporcionale.

### **3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)**

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë indikacion se humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet vetëm në atë masë që vlera kontabël neto e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar, duke zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

#### **3.5 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe ka një mundësi që të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

#### **3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat në lidhje me shërbimet e ofruara në bazë të një marrëveshje koncesionare për shërbime njihen me kalimin e kohës, në përputhje me politikën kontabël të Shoqërisë për njohjen e të ardhurave nga kontratat e shërbimit. Të ardhurat nga veprimtaria ose shërbimi njihen në periudhën në të cilën shërbimet ofrohen nga Shoqëria. Nëse marrëveshja e koncesionit të shërbimit përmban më shumë se një kusht performace, atëherë vlerësimi i marrë shpërndahet duke iu referuar çmimeve specifike relative të shitjes së shërbimeve të ofruara.

#### **3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi për fondet e investuara, huatë tek njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe fitime nga kursi i këmbimit.

Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet, humbjet nga kursi i këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.8 Përfitimet e punonjësve**

Shoqëria është e detyruar nga legjislacioni Shqiptar në fuqi të depozitojë kontributet fikse për llogari të punonjësve në një fond social që manaxhohet nga Qeveria. Të gjithë pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzim në periudhën në të cilën i takojnë.

### **3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **3.9 Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e bilancit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshëm në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshëm.

#### **3.10 Qiraja**

Shpenzimet e qirave, në të cilat një pjesë e madhe e riskut dhe përfitimeve të pronësisë mbarten nga qiramarrësi, klasifikohen si qira financiare. Pagesat e kryera për qiranë financiare (neto nga ndonjë përfitim të marrë nga qiradhënësi) ngarkohen në fitim ose humbje me metodë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

Faktorët të cilat konsiderohen përfshijnë gjatësinë e afatit të qirasë në lidhje me jetën ekonomike të aktivitetit, vlerën aktuale e pagesave minimale të qirasë në lidhje me vlerën e drejtë të aktivitetit, dhe nëse Shoqëria merr pronësinë e aktivitetit në fund të afatit të qirasë.

Të gjitha qiratë e tjera janë trajtuar si qira operative. Kur Shoqëria është një qiramarrësi, pagesat për marrëveshjet e qirasë operative njihen si shpenzim në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë.

#### **3.11 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënime shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënime shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provizionin, një detyrim njihet në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

#### **3.12 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe manaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.



#### 4 Manaxhimi i rrezikut financiar

##### 4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Manaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

###### (a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si pasojë e ndryshimit të çmimeve, kursit të këmbimit dhe normës së interesit në treg. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit shoqëria është e ekspozuar në një moment të caktuar varet nga kushtet në të cilat ndodhet tregu, pritshmëritë për çmimet në të ardhmen ose lëvizjet në normat e interesit të tregut, përbërja e aktiveve materiale të shoqërisë dhe kontratat në të cilat shoqëria është përfshirë.

###### (i) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria operon dhe është e ekspozuar ndaj kursit të këmbimit me valutat e huaja, veçanërisht me monedhat Euro dhe dollar amerikan. Rreziku i kursit të këmbimit vjen kur ka njohje të transaksioneve tregtare si aktive ose detyrime në një monedhë e cila është e ndryshme nga monedha funksionale e shoqërisë.

Shoqëria nuk e diversifikon ekspozimin ndaj këtij lloji rreziku sepse nuk pret humbje të konsiderueshme si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit me monedhat e huaja krahasuar me kursin në datën e raportimit.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 ka qenë si më poshtë:

31 dhjetor 2019	EUR	LEK	USD	Të tjera	Totali
<b>Aktivet financiare</b>					
Mjete monetare	8,818,593	50,678	-	-	8,869,271
Aktive të tjera	-	1,160,330			1,160,330
<b>Total</b>	<b>8,818,593</b>	<b>1,211,008</b>	-	-	<b>10,029,601</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Llogari të pagueshme	(5,277,642)	(4,495,936)	-	-	(9,773,578)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(100,324,564)	960,000			(99,364,564)
<b>Total</b>	<b>(105,602,206)</b>	<b>(3,535,936)</b>	-	-	<b>(109,138,142)</b>
<b>Rreziku nga kursi i këmbimit</b>					
<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>(96,783,613)</b>	<b>(2,324,928)</b>	-	-	<b>(99,108,541)</b>

###### Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhave të huaja

<b>2019</b>	<b>Shuma neto</b>	<b>10%</b>	<b>-10%</b>
EUR	(96,783,613)	(9,678,361)	9,678,361

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit, dhe një korrigjim i vlerave të tyre është bërë për 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlerat pozitive/negative tregojnë një rritje/ulje të fitimit ose kapitalit, e cila ndodh kur Leku forcohet/dobësohet ndaj një monedhe të huaj me +/- 10%.

###### (ii) Rreziku i normës së interesit

Të gjithë aktivitetet e shoqërisë të cilat mbartin interesa lidhen me llogaritë në banka. Të ardhurat e shoqërisë dhe flukset e parave nga aktiviteti operacional nuk janë të ekspozuar në masë të konsiderueshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

#### 4 Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### 4.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)

###### (b) Rreziku i kreditit

Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kreditit, i cili ka të bëjë me rrezikun që njëra palë e një instrumenti financiar të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke dështuar të shlyejë detyrimet. Rreziku i kreditit vjen nga paraja dhe ekuivalentët e saj, depozitat në banka dhe institucionet financiare si dhe ekspozimi nga kreditimi i klientëve, duke përfshirë llogaritë e arkëtueshme dhe transaksionet e kryera. Rreziku i kreditit që vjen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj dhe depozitat bankare konsiderohet i papërfillshëm, sepse pala tjetër janë banka me reputacion dhe me cilësi të lartë sipas klasifikimeve nga agjencitë e huaja.

Rreziku maksimal i ekspozimit të shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit përfaqësohet nga vlera e mbetur e secilit aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar të paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Mjete monetare	8,869,271
Aktive të tjera	1,160,330
<b>Totali</b>	<b>10,029,601</b>

###### (c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës. Balancat deri në 12 muaj barazohen me vlerën e tyre kontabël sepse ndryshimi me vlerën e skontuar nuk është i konsiderueshëm.

	Më pak se 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktivët financiarë</b>				
Mjete monetare	8,869,271	-	-	8,869,271
Aktive të tjera	1,160,330	-	-	1,160,330
<b>Total</b>	<b>10,029,601</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>10,029,601</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogari të pagueshme	(9,773,578)	-	-	(9,773,578)
Detyrime ndaj palëve të lidhura		(99,364,564)	-	(99,364,564)
<b>Total</b>	<b>(9,773,578)</b>	<b>(99,364,564)</b>	<b>-</b>	<b>(109,138,142)</b>
<b>Rreziku nga kursi i këmbimit 31 dhjetor 2019</b>	<b>256,023</b>	<b>(99,364,564)</b>	<b>-</b>	<b>(99,108,541)</b>

##### 4.2 Manaxhimi i rrezikut të kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar biznesin në vijimësi në mënyrë që të sigurojë përfitime për aksionaret dhe përfitime për palët e tjera të interesuara dhe të mbajë një strukturë optimale kapitali për të reduktuar koston e kapitalit.

Struktura e kapitalit të shoqërisë përbëhet nga kapitali i pronarit dhe humbjet e akumuluar. Drejtimi rishikon strukturën e kapitalit në terma vjetore.

## 5 Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjetet monetare analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2019
Në Lekë	50,678
Në Euro	8,818,593
<b>Tota</b>	<b>8,869,271</b>

Mjetet monetare në banka janë të lira në llogari rrjedhëse.

## 6 Aktive të tjera

Aktive të tjera analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2019
Shpenzime të llogaritura	1,160,330
TVSH e kreditueshme	14,927,718
Parapagime dogana	16,887
Paradhenie të tjera	110,933
<b>Total</b>	<b>16,215,868</b>

## 7 Aktive jo-materiale ne proces - e drejtë koncesionare

	Aktive Jo Materiale
<b>Kosto</b>	
Gjendja më 18 korrik 2019	-
Shtesa	71,652,037
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>71,652,037</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>	
Gjendja më 18 korrik 2019	-
Shtesa	-
Pakësime	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>	
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>71,652,037</b>

Aktive jo-materiale në proces - e drejtë koncesionare përfshin kostot e blerjes së sistemeve matëse të pistoletave të karburantit dhe GLN si dhe pajisjet ndihmëse për procesin e verifikimit; kostot për dizajnimin dhe zhvillimin e programit kompjuterik; blerjen e 7 furgonave të rinj për ekipet e inspektorëve në terren; blerjen e pajisjeve kompjuterike (mackbook dhe IPAD) etj.

Data efektive e fillimit të punimeve është 31 mars 2020. Investimet për koncesionin janë njohur si aktive ne proces dhe nuk janë amortizuar sepse NOA Inspect nuk ka gjeneruar të ardhura gjatë vitit 2019.

## 8 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme nga aktiviteti	9,773,578
<b>Total</b>	<b>9,773,578</b>

**Shoqëria Koncesionare Noa Inspect shpk**

Shënimet për pasqyrat financiare

Më dhe për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2019

*Shumat janë të shprehura në LEK, me përjashtim të rasteve kur shprehet ndryshe***9 Detyrime të tjera**

Detyrime të tjera analizohen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	516,656
<b>Total</b>	<b>516,656</b>

**10 Detyrime ndaj palëve të lidhura**

	<b>31 dhjetor 2019</b>
Të pagueshme ndaj Noa Control	93,168,564
Të pagueshme ndaj Noa Energy	6,196,000
<b>Total</b>	<b>99,364,564</b>

Noa Control është Ortak i vetëm i Shoqërisë Koncesionare, NoA Inspect, dhe financuese e kësaj Shoqërie.

**11 Kapitali i paguar**

Kapitali i paguar më 31 dhjetor 2019 analizohet si më poshtë:

		<b>31 dhjetor 2019</b>
<b>Ortakët</b>	<b>Pjesëmarrja %</b>	<b>lekë</b>
Noa Control shpk	100%	1,000,000
<b>Total</b>	<b>100%</b>	<b>1,000,000</b>

**12 Shpenzime administrative**

Shpenzime administrative analizohen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>
Shpenzim Certifikimi	2,702,732
Sigurime	2,586,798
Transferime, udhëtim, dieta	1,462,030
Shpenzime të tjera	946,300
Qira	238,414
Konsulencë	552,345
Transporte për blerje	375,913
Shërbime bankare	159,512
Noterizime	129,167
Trajnime	139,283
Shpenzime doganore	99,975
Shpenzime për makina	98,990
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	85,770
Shërbim Ata Carnet	61,535
Tatime të tjera	41,744
Taksa dhe tarifa vendore	34,319
Parkim	39,800
Shpenzim Kancelari	16,250
Mirëmbajtje dhe riparime	16,000
Qira Paisje	14,250
Shpenzime,postare e telekomukacioni.	8,380
Përkthime	5,415
<b>Total</b>	<b>9,814,922</b>

### 13 Shpenzime personeli

Shpenzime personeli analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Paga	3,153,221
Kontribute shoqërore dhe shëndetsore	382,755
<b>Totali</b>	<b>3,535,976</b>

### 14 Tatim Fitimi

	31 dhjetor 2019
Humbja para tatimit	(13,917,622)
Rregullime për:	
Shpenzime të pazbritshme	1,032,070
<b>Humbja tatimore</b>	<b>(12,885,552)</b>
Norma e taksës Shqipëri	15%
<b>Tatimi mbl fitimin</b>	<b>-</b>

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2019 është 15% (2018; 15%). Deklaratat tatimore janë plotësuar për çdo vit por fitim-humbjet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten si parashikime derisa autoritetet tatimore kontrollojnë ato dhe regjistrimet e taksapaguesit dhe lëshohet një vlerësim final.

Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e palejuara për efekte tatimore paraqesin shpenzime të pambështetura me dokumentacionin përkatës apo shpenzime të konsideruara të panjohura për efekte fiskale.

### 15 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

#### *Çështje ligjore*

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, Shoqëria nuk do të ketë ngjarje me peshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve, përveç atyre për të cilat është njohur një provizion në pasqyrat financiare.

#### *Detyrime të kushtëzuara*

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

### 16 Transaksionet me palët e lidhura

Shoqëria gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm ka transaksione me palët e lidhura. Tabela më poshtë është një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura:

	Të arkëtueshme	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>				
NOA Energy shpk	-	(6,196,000)	-	-
NOA Control Sh.p.k	-	(93,168,564)	-	-
	<b>=</b>	<b>(99,364,564)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

## **17 Ngjarje pas datës së raportimit**

Gjatë fillimit të vitit 2020, globalisht u përhap pandemia e COVID -19. Në Shqipëri, impaktin masiv e pati prej muajit mars 2020, kur qeveria mori masa drastike duke pezulluar aktivitetet, të cilat nuk ishin jetike.

Pavarërisht se kjo është ende një situatë në zhvillim në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, deri më tani nuk ka patur ndonjë ndikim të dukshëm në veprimtarinë e Shoqërisë. Manaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshme për të zbutur çdo efekt.

Me anë të shkresës nr.1488, datë 11 mars 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka konstatuar se koncensionari ka realizuar të gjithë vlerën e investimit të kontraktuar në përputhje me elementët e përcaktuar në planin e biznesit.

Me anë të shkresës nr.2144, datë 27 mars 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë informoi se prej datës 31 mars 2020 shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm do të ofrohet nga shoqëria koncensionare "NOA Inspect".

Nuk ka asnjë ngjarje tjetër të mëpasshme pas datës së raportimit, e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.



[www.granthornton.ai](http://www.granthornton.ai)